

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimeve “[B...].c, Basel, të cilin e përfaqëson “[I...].“ L.L.C. nga Prishtina, - “[B.N]“, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “[E...].”, me seli në Prishtinë, për shkak të regresit, në shumën prej 7,507.00 €, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.C.nr. 260/14, të datës 09.03.2017, në seancën e kolegit të mbajtur me datë 28.01.2019, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “[E...].”, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.C.nr. 260/14, të datës 09.03.2017, **VËRTETOHET**.

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, në piken I të dispozitivit te aktgjykimit e ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Kompania e Sigurimeve “[B...].“ ashtu që detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “[E...].“ me seli në Prishtinë, që ne emër të reimbursimit mbi bazën e subrogimit, nga aksidenti i datës 08.08.2012, paditëses t'ia paguaj shumën prej 7,507.00 €, me kamtë ndëshkuese prej 12% në vit duke filluar nga data 17.05.2013, e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi. Ndërsa ne piken II të dispozitivit është detyruar e paditura që në emër te kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditësit t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1,573.89 €, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura Kompania e Siurimeve “[E...].”, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë te gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, Aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtine – Departamenti për çështje Ekonomike IV.C.nr. 260/14, të datës 09.03.2017, ta prishe dhe lenden t'ia kthej Gjykatës së parë në rivendosje dhe rigjykim, apo të njejtin ta ndryshojë dhe ta refuzojë në tërsi kërkesëpadinë si të pabazuar.

Paditësi në përgjigje në ankesë ka propozuar që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pabazuar dhe te vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike IV.C.nr. 260/14, të datës 09.03.2017.

**Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se, Kompania e Sigurimeve “[B... ]”, me datë 25.03.2014, ka parashtruar padi regresi, kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “[E... ]”, me seli në Prishtinë, për rimbursimin e dëmit të paguar nga kontrata e sigurimit të auto-kasko, të cilën ë mbeshtet në institutin e subrogimit. Shpërbllimi i dëmit i trajtuar dhe paguar nga baza e sigurimit auto kasko referohet aksidentit të trafikut të datës 08.08.2012, i cili ka ndoshur në magjistralen Ferizaj. Ky aksident është shkaktuar nga vozitësi “[S.G]”, nga Ferizaji, i siguruar te e paditura, me përdorimin e automjetit të markës “Opel Kadet” me targa “[...]”, me çrast është dëmtuar automjeti i siguruar kasko tëk paditësja “BMW-M3” me targa të Zvicrës “[...]”.

Gjykata e shkalles së pare nga provat e administruara ka konstatuar se me datën 08.08.2012, ne magjistralen Gjilan -Ferizaj, ka ndodhur aksidenti i trafikut, i cili është shkaktuar më fajin eksluziv të siguruarit të së paditurës “[S.G]”, nga Ferizaji, i cili me përdorimin e automjetit të markës “Opel Kadet” me targa “[...]”, ka shkaktuar aksidentin.

Gjykata e shkallës së pare ka konstatuar se nga polica e sigurimit autokasko me nr. 40/6.271.803-5 , shihet se automjeti i markës “BMW-M3” me targa të Zvicrës “[...]”, është siguruar, tek pala paditëse mbi bazën e sigurimit autokasko. Nga raporti i aksidentit me nr.2012CFT 417, i datës 08.08.2012, përpiluar nga Policia e Kosovës, si dhe nga provat e tjetra të lendet shihet se, gjate kohës se sigurimit me datën 08.08.2012, ka ndodhur aksidenti i trafikut në mes të automjetit të siguruar auto-kasko dhe një automjeti tjetër te markës “Opel Kadet” me targa “[...]”. Gjykata duke u mbështetur në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe në ekspertizën e makinerisë, e punuar nga eksperti “[N.SH]”, ka konstatuar se automjeti i siguruar me kasko sigurim tek paditësja, është dëmtuar nga aksidenti i komunikacionit dhe lartësia e dëmit te shkaktuar , është në shumën prej 7,507.00 €. Prandaj, gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke u bazuar në dispozitat e Nenit 154.1, dhe 178.1 të LMD-së, lidhur me Nenin 939 të LMD-së.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsy se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga nen 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkalles së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 939 par.1 të LMD-së, me të cilin është përcaktuar se “*me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin, në bazë të vetë ligjit, deri në shumën e kompensimit të paguar, të gjitha të drejtat e të siguruarit ndaj personit i cili mbi cilën bazë qoftë është përgjegjës për dëmi*”. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se përgjegjës për dëmin e shkaktuar në aksidentin e datës 08.08.2012, ka qenë i siguruari i të paditurës, me ç‘rast

paditësi ia ka paguar të siguruarit të tij kompensimin e dëmit të pësuar dhe me pagimin e kompensimit të gjitha të drejtat e të siguruarit kanë kaluar të paditësi.

Gjykata e Apelit i shqyrtoj pretendimet ankimore të paditurës në lidhje me mbulesën siguruese të automjetit të dëmtuar, në territorin e Kosovës, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara për arsy se nga prezantimi i kushteve të sigurimit të paditëses “[B...J” rezulton se Kosova nuk bën pjesë në grupin e shteteve ku përjashtohet sigurimi, respektivisht Kosova përfshihet në territorin e cila mbulohet me sigurim, ndërsa Kushtet e Sigurimit janë pjësë përbëresë e kontratës së sigurimit dhe krijojnë efekt të plotë juridik.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të së paditurës, lidhur me lartësinë e normës së kamatës, por gjeti se të njëjtat janë ta pabazuara, ngase neni 26, pika 6, i Ligjit mbi Sigurimin e Detyruar nga Auto përgjegjësia, përcakton lartësinë e kamatës prej 12% nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërbllim. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë ia ka njojur kamatën nga data e parashtrimit të kërkesës te e paditura, datë 08.08.2012, andaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditurit lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë, përmes ekspertizave përkatëse, e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërthënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsyë të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,  
Ae.nr. Ae.nr 104/2017, dt. 28.01.2019**

**KRYETARI I KOLEGJIT,**

**Mahir Tutull, d.v**

